

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me daten 14.07.2020 nenshkruhet kjo kontrate shitblerje kuotash nga palet:

- “**Farmaci Emira – 2011**” shpk me Nr NIPT: L32127010C me ortak te vetem dhe administrator **Z. Erald Lengo**, i datelindjes 20.07.1994, i biri i Sadikut, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, zoteruese e 50% te kuotave te shoqerise, *Referuar si “Shitësi”*

DHE

-**EEM INVESTMENT**” shpk person juridik i tatushem me nr. NIPT-i L71712013R me ortak te vetem dhe administrator **Z. Elio Latifi**, , i datelindjes 28.06.1993, i biri i Iljasit lindur ne Gramsh dhe banues ne Tirane, me nr.personal J30628114I madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, zoteruese e 50% te kuotave te shoqerise, *Referuar si “Blerësi”*

NENI 1-PERKUFIZIME

Paragrafi 1.01. Përkuftizime

Kudo që përdoren në këtë kontratë (duke përfshirë Shtojcat), përveçse nëse deklarohet ndryshe ose e kërkon konteksti, termat e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Kuotat”	do të thotë 100% te kuotave te shoqerise “Habe Invest” shpk
“Përfundimi”	do të thotë përfundimi i shitjes dhe blerjes së kuotave ndermjet shoqerise “Farmaci Emira – 2011” shpk dhe shoqerise EEM INVESTMENT” qe zoterojne tek shoqeria “Habe Invest” shpk, në përputhje me këtë kontratë.
“Lekë” ose “ALL”	do të thotë monedha e ligjshme e Republikës së Shqipërisë.
“Barrë”	do të thotë çdo hipotekë, peng, pagesë, privilegj, prioritet, hipotekim, barrë, kalim, sekuestro, kompensim ose interesa sigurie të çdo lloji në lidhje me Kuotat.

NENI II – SHITJA DHE BLERJA E KUOTAVE

Paragrafi 2.01. Mënyra e shitblerjes se Kuotave

Shoqeria “Farmaci Emira – 2011” shpk ti shese shoqerise “EEM INVESTMENT” shpk, te gjithe kuotat zoteruese qe ka tek shoqeria “HABE INVEST” shpk, me cmimin 50 leke.

Shoqeria “EEM INVESTMENT” shpk ti bleje shoqerise “Farmaci Emira – 2011” shpk, te gjithe kuotat zoteruese qe ka tek shoqeria “HABE INVEST” shpk, me cmimin 50 leke.

Shoqeria “EEM INVESTMENT” shpk te jete zoteruese e 100% te kutave te shoqerise “Habe Invest” shpk

Paragafi 2.01. Çmimi i Blerjes

Sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, Shitësi bie dakord ti shesë Blerësit dhe Blerësi bie dakord të blejë nga shitësi të gjithë të drejtat, titujt, përfitimet dhe interesat e Shitësit ne dhe mbi kuotat në Datën e Përfundimit, për Çmimin e Blerjes.

Paragafi 2.02. Afati i Pageses

Sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, Blerësi do të paguajë çmimin e Blerjes sipas marreveshjes mes paleve.

Paragafi 2.03. Hyrja ne fuqi e kontrates

Kontrata hyn ne fuqi menjehere pas nenshkrimit nga palet

Paragafi 2.04. Kushtet për përfundim

Sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, në datën e përfundimit, Blerësi do të paguajë çmimin e Blerjes me transfertë bankare ose cash në fonde direkt të disponueshme, pa kompensim apo kundërkérkesë, në llogarinë e përcaktuar.

NENI III – GARANCITE

Paragrafi 3.01. Garancitë e Blerësit


Blerësi i garanton Shitësit se në datën e kësaj kontrate dhe në Datën e Përfundimit:

- (a) Ai ka të drejtën të lidhë dhe të zbatojë këtë kontratë;
- (b) Kjo kontratë është autorizuar dhe ekzekutuar rregullisht prej tij dhe kjo kontratë përbën detyrime të vlefshme dhe ligjërisht detyruesh të tij, të detyrueshme në përputhje me kushtet e kësaj kontrate;
- (c) Kryerja e kësaj kontrate dhe përputhja me kushtet e saj nuk do të rezultojë në shkeljen e aktit të tij te themelimit ose të çdo dispozite të përbajtur në çdo status, ligj, normë, rregullore, vendim ose dekret të aplikueshëm ndaj tij dhe nuk do të jenë në kundërshtim ose të rezultojnë në shkeljen e ndonjë dispozite ose të kërkojë çdo miratim ose të rezultojë në vendosjen e ndonjë barre si pagesë garancie sipas çdo kontrate ose dokumenti në të cilin është palë ose nga i cili detyrohet ai ose ndonjë aset i tij;
- (d) Blerësi lidh këtë Kontratë dhe do të ushtrojë të drejtat e tij dhe do të kryejë detyrimet e tij sipas saj, vetëm për përfitimin e tij dhe jo për ose në emër të ndonjë personi tjeter, qoftë si administrues i besuar, agjent ose ndryshe, dhe
- (e) Blerësi është në gjendje të përmbushe të gjitha pagesat e tij dhe detyrimet e tjera siç janë për tu paguar për kryerjen dhe nuk është depozitar asnjë kërkesë për falimentim ose procedimin e detyruar ndaj tij dhe as nuk kërcënohet ose parashikohet një gjë e tillë.
- (f) Bleresi fiton cdo detyrim dhe te drejte te cfaredo lloji qe lidhet me shoqerine "Habe Invest"shpk, qe eshte perfituar ose rrjedh nga veprime ne te shkuaren si dhe ato qe do te perfitoohen ne te ardhmen.

Paragrafi 3.02. Garanci të Shitësit

Shitësi i garanton Blerësit se në datën e kësaj Kontrate dhe në datën e Përfundimit:

- (a) Ai ka të drejtë të lidhë dhe të kryejë këtë Kontratë;
- (b) Kjo kontratë është autorizuar dhe ekzekutuar rregullisht prej tij dhe kjo Kontratë përbën detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht të detyrueshëm të tij, të detyrueshme në përputhje me kushtet e kësaj kontrate;



- (c) Kyerja e kësaj Kontrate dhe përputhja me kushtet e saj nuk do të rezultojë në shkeljen e aktit të tij të themelimit ose të çdo dispozite të përbajtur në çdo statut, ligj, normë, rregullore, vendim ose dekret të aplikueshëm ndaj tij dhe nuk do të jetë në kundërshtim ose të rezultojë në shkeljen e ndonjë dispozite ose të kërkojë çdo miratim ose të rezultojë në vendosjen e ndonjë barre si pagesë garancie sipas çdo kontrate, ose dokumenti në të cilin është palë ose nga i cili detyrohet ai ose ndonjë aset i tij;
- (d) Në datën e kësaj Kontrate, Shitësi nuk ka lidhur dhe as ka rënë dakord të lidhë ndonjë kontratë tjeter për shitjen e Kuotave qe zoteron te shoqerisa "Habe Invest" shpk , përveçse me blerësin;
- (e) Shitësi i garanton Blerësit që Kuotat janë të lira nga çdo barrë si Garanci pagese apo çdo lloj pengese që mund të përbëjë – në Përfundim ose pas tij – një shkelje të të drejtave të pronësisë së Kuotave nga Blerësi.
- (f) I transferon te gjitha te drejtat dhe detyrimet e fituara, duke perfshire cdo lloj dokumentacioni qe ka perfituar ose do te perfitoje pa asnje perjashtim.
- (g) **Shitesi nuk do te pretendoje asnje te drekte ose detyrim ne te ardhmen lidhur me shoqerine Habe Invest shpk**

NENI IV – TE PERGJITHSME

Paragrafi 4.01. Njoftimet

Çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjeter që jepet ose bëhet sipas kësaj Kontrate do të jetë me shkrim. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, ky njoftim, aplikim ose komunikim tjeter do të konsiderohet se është dhënë ose bërë rregullisht kur dorëzohet dorazi, me postë ajrore, transmetim teleks ose faks ndaj palës së cilës i kërkohet ose i lejohet të jepet ose të bëhet në adresën e kësaj pale të specifikuar më poshtë ose në atë adresë tjeter që kjo palë cakton me njoftim ndaj palës që jep ose bën këtë njoftim, aplikim ose komunikim.

Paragrafi 4.02. Gjuha Shqipe

Të gjitha dokumentat që do të sigurohen ose komunikimet që do të jepen ose bëhen sipas kësaj Kontrate do të jenë në gjuhen Shqipe.

Paragrafi 4.03. Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë do të drejtohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

Paragrafi 4.04. Juridiksioni

Çdo konflikt, mosmarrëveshje ose pretendim që lind nga kjo Kontratë ose në lidhje me këtë Kontratë ose shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhet mirekuptim. Nese nuk do te arrihet një marreveshje atehere cdo mosmarreveshje do te zgjidhet nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë.

PALET

“Farmaci Emira – 2011” shpk

Z. Erald LENGO



EEM INVESTMENT” shpk

Z. Elio LATIFI

